



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

KËRKESË

THIRRJE PËR REFLEKTIM

Drejtuar:

KRYEMINISTRIT

MINISTRISË SË DREJTËSISË

MINISTRISË SË FINANCAVE

Ne, përbaruesit gjyqësorë privatë, anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, sot më 1 shkurt 2025, vendosëm t'i drejtohem i përfundimisht Kryeministrit dhe dy ministrave të tij për ndërprerjen e praktikës arbitrare dhe të padrejtë që po çon në shkatërrimin e shërbimit përbarimor gjyqësor privat në vend, me shkak kryesor mbajtjen peng të tarifave të drejta, incentivuese të ofrimit të shërbimit tonë profesional.

Kjo është një thirrje e fundit për reflektim dhe veprim nga ana juaj si institucione përgjegjëse, përpara se të detyrohemi që, përveç adresimit kolegjal ligjor, të marrim njëkohësisht **masa të detyrueshme ekstreme** në mbrojtje të dinjitetit dhe profesionit tonë.

Mosmiratimi i tarifave të shërbimit përbarimor gjyqësor privat, gjysmë dekade, është një cenim i drejtpërdrejtë i pavarësisë së këtij profesioni dhe një përpjekje për të gjuhëzuar një shërbim themelor të sistemit të drejtësisë. Për 5 vite rresht, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave kanë refuzuar të përmbushin e zbatojnë një detyrim ligjor, duke e lënë shërbimin përbarimor privat në një krizë që ka shkaktuar paralizë ekonomike dhe profesionale.

Refuzimi i miratimit të tarifave të shërbimit përbarimor gjyqësor privat nga sot nuk mund të konsiderohet më neglizhencë burokratike, por një strategji e mirëllogaritur për të çuar drejt shuarjes këtë shërbim, në favorizim të entiteteve që kërkojnë të ushtrojnë në mënyrë të padrejtë mbledhjen dhe ekzekutimin e detyrimeve sipas standardeve ligjore.

Rrënimi i shërbimit të përbarimit gjyqësor privat po sjell pasoja të rënda jo vetëm për profesionistët që e ushtrojnë atë, por veçanërisht për mijëra qytetarë dhe subjekte ekonomike, të cilët kanë të drejtën e zgjedhjes së alternativës private për një ekzekutim të drejtë dhe efektiv të titujve ekzekutivë.



Goditja e qëllimshme me pavëmendje shtetërore e këtij shërbimi po shkatërron në mënyrë sistematike dhe degradon këtë profesion, duke krijuar një premisë të fortë për minimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Kjo është **një përpjekje jonë e fundit** që kërkon reflektimin dhe ndërhyrje urgjente nga ana juaj, për të ndaluar këtë situatë të paprecedentë ligjore dhe shtetërore.

Pasi kemi ndjekur dhe ezauruar të gjitha mjetet që na njeh sistemi demokratik, përfshirë edhe këtë thirrje kolegjiale, ju bëjmë thirrje për reflektim dhe kërkojmë:

1. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave të publikojnë pa asnjë vonesë të mëtejshme në Fletoren Zyrtare aktin nënligjor përkatës që vendos tarifën fikse të shërbimit përmbartimor gjyqësor privat.
2. Kryeministri i Shqipërisë të ndërhyjë urgjentisht për të zgjidhur këtë situatë të abuzimit administrativ dhe ligjor 5-vjeçar, që kryhet nën qeverisjen tij, nga dy ministra të tij, e që po minon funksionimin e një shërbimi thelbësor për shtetin e së drejtës në Shqipëri.
3. Ju, si institucione përgjegjëse, të respektoni pavarësinë dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor gjyqësor privat, duke mos e përdorur detyrimin për nxjerrjen e një akti nënligjor si mjet presioni, favorizimi apo të ndikimit me prapavijë politike.

Nëse edhe kësaj here kërkesa jonë e drejtë dhe legjitime do të injorohet, refuzohet apo lihet në heshtje, ne do të gjendemi para detyrimit të ndërmarrjes së hapave ekstremë reagues, ku nuk përjashtohet dhe përfshihet bojkotimi kolektiv i ofrimit të shërbimit përmbartimor, një akt që do të sillte pasoja të pallogaritshme për:

- Ne si profesionistë, të cilët po pengohemi qëllimisht të ushtrojmë një profesion të lirë dhe të pavarur.
- Mijëra qytetarë dhe biznese, të cilët do të përballëshin me një kolaps të plotë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutivë.
- Sistemin juridik dhe shtetin e së drejtës, duke krijuar një precedent të rrezikshëm të bllokimit të një mekanizmi themelor të drejtësisë.

Kjo është një thirrje e imponuar prej jush, e diktuar nga ju dhe, duke konsideruar rrethanat ekstreme që po kalon për një kohë të gjatë profesioni ynë, anëtarësia e tij, e në tërësi gjithë shërbimi përmbartimor gjyqësor privat shqiptar, kjo thirrje për reflektim, nuk mund të jetë përveç se e fundit.

Ne nuk kërkojmë privilegje, asgjë të padrejtë, por vetëm respektim të ligjit dhe të parimeve bazë të një shteti demokratik, ndaj dhe po ju drejtohem, duke ju kujtuar se çdo vonesë e mëtejshme, përveçse e paligjshme, do të jetë një hap i pakthyeshem në drejtim të pasojave që sjell minimi i shtetit të së drejtës.

Sot është momenti që ju si institucione të tregoni nëse do të zgjidhni rrugën e drejtësisë dhe ligjit apo do të vazhdoni të mbani kursin disavjeçar të mohimit të tij.

Kjo kërkesë, në formën e një thirrjeje për reflektim, u miratua sot më 1.2.2025, nga Asambleja e Përgjithshme e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

## **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

*Vendi i zhvillimit të Asamblesë: Ministria e Drejtësisë*

*Datë: 1.2.2025*

*Pjesëmarrja: 73 përmbartues*

